



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 67
Prishtinë, më 28 qershor 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 28 QERSHOR 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryesuesi Xhavit Haliti i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Lutfi Haziri, i cili tha se e tërheq fjalën e tij në këtë pikë të rendit të ditës, pas incidentit të sotëm në kufirin e Kosovës me Serbinë, Teuta Sahatqija, Albin Kurti, Donika Kadaj-Bujupi, Ganimete Musliu, Haki Demolli, Teuta Haxhiu, Fadil Demaku, ministri Enver Hoxhaj dhe zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Glauk Konjufca parashtoi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj në lidhje me faktin se a është në dijeni ministria që ai drejton se në afërsi të kufirit me Serbinë, në Hungari, janë të arrestuar 104 shqiptarë, paraburgimi i të cilëve është duke zgjatur deri në tetë muaj. A keni vendosur kontakte me autoritetet e Hungarisë dhe sa veta janë riatdhesuar. Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Glauk Konjufca.

Deputetja Kymete Bytyçi parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me masat që ka ndërmarrë ministria që ai drejton për mundësinë e zhdukjes së rriqrave nga zonat e prekura si komuna e Malishevës etj., të cilat kanë shkaktuar edhe raste të vdekjes së njerëzve. Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Kymete Bytyçi.

Deputetja Salihe Mustafa parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me ekzistimin e ndonjë plani të ministrisë që ai drejton për zgjerimin e hapësirave të QKUK-së. Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Salihe Mustafa.

Në vazhdim, për fjalë u paraqit deputeti Adem Grabovci.

Adem Grabovci tha se sot e kemi një situatë të re në kufirin Kosovë-Serbi, në Merdar, ku sipas njoftimeve të para kemi disa policë të plagosur, andaj kërkoj nga ministri i Punëve të Brendshme që para Kuvendit ta paraqesë një informatë për këtë çështje.

Ministri **Bajram Rexhepi** tha se me rastin e shënimit të përvjetorit të Betejës së Kosovës - 1389, e cila te popullata serbe njihet si Dita e Vidovdanit, grupe të organizuara serbe kanë depërtuar në territorin e Republikës së Kosovës për ta shënuar këtë ditë. Në mesin e tyre dy autobusë që ishin nisur në drejtim të Gazimestanit kanë shfaqur provokime të ndryshme dhe të natyrës politike, shumë nga të cilët ishin në gjendje të dehur. Policia e Kosovës, me urdhër të Ministrisë që ai drejton, ka vendosur që këta dy autobusë të kthehen në territorin serb në vendkalimin në Merdar. Pas kësaj, nga territori i Serbisë në drejtim të Policisë së Kosovës ka pasur gjuajtje me gurë dhe gjësende të tjera të forta, e për pasojë kanë marrë lëndime trupore 32 zyrtarë policorë. Disa nga këta zyrtarë policorë janë trajtuar në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Podujevë, kurse disa të tjerë në QKUK. Asnjëri nga këta të lënduar nuk është i plagosur me armë zjarri, tha ministri Rexhepi.

Kufiri Kosovë-Serbi është mbyllur për momentin për shkaqe sigurie, nuk ka hyrje të organizuara nga ana e territorit serb, ndërsa rasti është duke u hetuar nga Policia e Kosovës, konstatoi ministri.

Informata e plotë e ministrit Rexhepi është dhënë e plotë në transkriptin e kësaj mbledhjeje plenare.

Në vazhdim, në lidhje me këtë çështje diskutuan edhe deputetët: Rexhep Selimi, Sabri Hamiti, ministri Ferid Agani, Burim Ramadani, Behar Selimi, Arben Gashi, kryeministri Hashim Thaçi dhe Ahmet Isufi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim të punimeve të Kuvendit, kryetari i njoftoi deputetët se në lidhje me plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme kemi dy propozime:

1. Propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme plenare me pikën - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Për këtë propozim diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj - në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha

Milosavljeviq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Komisioni për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme plenare me pikën - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,
Kundër ----- 27,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e Komisioni për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme plenare me pikën - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Kjo pikë radhitet si pikë numër tetë e rendit të ditës.

2. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme plenare me pikën - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfuqizimin e neve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penat të Kosovës.

Ky propozim i Grupit Parlamentar të PDK-së është i bazuar në nenin 84 të Rregullores së Kuvendit.

Për këtë propozim diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Milosavljeviq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Arben Gashi - në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Lutfi Haziri - në emër të Komisionit për Integritet Evropian dhe kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari Jakup Krasniqi, para hedhjes në votim të këtij propozimi, konstatoi se në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, për t’iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në mbledhje plenare.

Kryetari hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së për plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme plenare me pikën - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penat të Kosovës.

Në sallë ishin të pranishëm 96 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 28,
Abstenime ----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së për plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme plenare me pikën - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penat të Kosovës.

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 22 qershor 2012,
4. Votimi i raportit të punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për vitin 2011,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftime,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetësi,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012,
9. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave,
10. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 22 qershor 2012

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 22 qershor 2012.

4. Votimi i raportit të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për vitin 2011

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës konstatoi se në mbledhjen plenare, të mbajtur më 22 qershor 2012, Kuvendi në mungesë të kuorumit nuk ka proceduar me votimin e raportit të punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për vitin 2011. Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen plenare të kaluar.

Kryetari procedoi me votimin e raportit të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 71,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor, për vitin 2011.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftime

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për letërnjoftime.

Ministri **Bajram Rexhepi** tha se ky Projektligj është hartuar sipas programit legjislativ për vitin 2012.

Në vazhdim theksoi se arsyet e plotësimit dhe ndryshimit të ligjit për letërnjoftime qëndrojnë në faktin se disa nga dispozitat përkatëse lidhen me sistemin për avancimin e mëtejshëm të të dhënave biometrike.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është lëshimi i letërnjoftimeve biometrike.

Më pas, ministri u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit, i cili përmban 12 nene.

Projektligji është i harmonizuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe u është përshtatur rrethanave të reja në Republikën e Kosovës, si dhe është i harmonizuar me legjislacionin e BE-së, tha ai.

Në fund, ministri Rexhepi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftime.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftime.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fatmir Xhelili - në emër të Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Vjollca Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Rexhep Selimi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ahmet Isufi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Goran Marinković - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Ganimete Musliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftime.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 65,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftime.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si Komision Funkcional dhe Raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji.

Ministrja **Mimoza Kusari-Lila** tha se Qeveria e Kosovës dhe ministria që ajo drejton ka vendosur që ky projektligj të jetë një nga prioritetet për këtë vit, pasi gjithashtu edhe në Raportin e Progresit të vitit 2011 është rekomanduar që ligji në fuqi të përafrohet me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Në vazhdim, ministrja theksoi se deri më tani në Kosovë ka pasur përkushtim të madh për ndërtimin e një sistemi adekuat të metrologjisë, në përputhje me kërkesat e BE-së dhe sipas nevojave dhe kapaciteteve të Kosovës.

Më tej, ajo u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit, me theks të veçantë në ndryshimet e parapara në këtë projektligj

Në fund, ministrja Kusari-Lila i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për metrologji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti - në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Sala Berisha-Shala - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Teuta Sahatqija - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Lutfi Zharku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 77,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision Funksional dhe Raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetësi

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për shëndetësi.

Ministri **Ferid Agani** tha se projektligji për shëndetësinë adreson çështjet që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor në nivelin parësor, dytësor dhe tretësor, organizimin dhe zbatimin e kujdesit shëndetësor, veprimtarinë shëndetësore, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e institucioneve shëndetësore, politikat zhvillimore dhe financimin e kujdesit shëndetësor, shërbimin kombëtar të shëndetësisë, punëtorët shëndetësorë, veprimtarinë private shëndetësore, krijimin e odës profesionale shëndetësore etj.

Në vazhdim, ministri u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit, i cili përbëhet prej 96 neneve, me theks të veçantë në elaborimin e kapitujve të projektligjit.

Në fund, ministri Agani i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për shëndetësi.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për shëndetësi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka - në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Flora Brovina - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nazane Breca - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Time Kadriaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gëzim Kelmendi - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Fikrim Damka - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Haki Demolli, Salihe Mustafa, Afrim Kasolli, Aurora Bakalli, Jeton Svirca, Ardian Gjini, Bekim Haxhiu, Rita Hajzeraj-Beqaj, Muhamet Mustafa, Ramadan Thaçi dhe ministri Ferid Agani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra tha se diskutimin e saj për këtë pikë të rendit të ditës do ta dorëzojë me shkrim.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për shëndetësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër ----- 16,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për shëndetësi.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision Funkcional dhe Raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Ministri **Bedri Hamza** tha se ndryshimi dhe plotësimin i ligjit nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012 është i bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Në vazhdim ai tha se ndryshimet dhe plotësimet e parapara në këtë Projektligj janë të harmonizuara edhe me përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Më tej, ministri Hamza vlerësoi se treguesit makroekonomikë në këtë Projektligj janë të qëndrueshëm, ndërsa theksoi se presim që deficitin tregtar në fund të vitit të jetë akoma më i vogël se sa është paraqitur në këtë Projektligj.

Në pas, ministri u fokusua në sqarimin e parametrave tjerë të organizatave buxhetore, të paraparë në Projektligj.

Në fund, ministri Bedri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sali Asllanaj - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Muhamet Mustafa - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Jelena Bontiq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Hasime Krasniqi, Ganimete Musliu dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 50,
Kundër ----- 26,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision Funkcional dhe Raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin në afatin sa më të shpejtë të mundshëm dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave

Deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, tha se si komision e kemi shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për

emërimit e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave dhe kemi rekomanduar miratimin në mbledhje plenare.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimit e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Jelena Bontiq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Emilija Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimit e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 50,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 12.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave emërohen:

1. Artan Qerkini - anëtar,
2. Refik Ramaj - anëtar,
3. Qemajl Smajli - anëtar,
4. Dragan Djorgoviq - anëtar.

II. Mandati i të emëruarve nga pika I. e këtij vendimi zgjat deri më 31 dhjetor 2013.

10. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, tha se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2012, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në mbledhjen e sotme plenare t’i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve.

Në vazhdim, kryetari i ftoi kryetarët /përfaqësuesit/ e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc.

Grupet parlamentare i propozuan këta anëtarë:

GP i PDK-së i propozoi deputetët Idriz Vehapi dhe Xhevahire Izmaçu;

GP i LDK-së i propozoi deputetët Lutfi Haziri dhe Arben Gashi;

GP i LV e propozoi deputetin Afrim Kasolli;

GP i AAK-së e propozoi deputeten Teuta Haxhiu;

GP i Koalicionit Kosova e Re e propozoi deputetin Jeton Svirca;

GP i SLS-së e propozoi deputetin Milivoje Stojanović, si dhe

GP "6+" e propozoi deputetin Albert Kinolli.

Pas këtyre propozimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin e grupeve parlamentare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,

Kundër ----- 0,

Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës në këtë përbërje:

1. Idriz Vehapi nga PDK,
2. Xhevahire Izmaçu nga PDK,
3. Lutfi Haziri nga LDK,
4. Arben Gashi nga LDK,
5. Afrim Kasolli nga "Vetëvendosje",
6. Teuta Haxhiu nga AAK,
7. Jeton Svirca nga Koalicioni Kosova e Re,
8. Milivoje Stojanović nga SLS,
9. Albert Kinolli nga "6+".

II. Komisioni parlamentar ad hoc, në bazë të nenit 26 pika 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radio-Televizionin e Kosovës duhet t'i shqyrtojë dhe t'i përzgjedhë kandidaturat e paraqitura për anëtarë të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme në orën 17:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Drejtoria për çështje plenare dhe procedurale